



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, datë 17.02.2026, lidhur me rastet e përmytjeve në territorin e Bashkisë Shkodër, ju bëjmë me dije sa vijon:

Bashkia Shkodër është një nga njësitë vendore më të ekspozuara ndaj rrezikut të përmytjeve, për shkak të pozicionit gjeografik në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Drin, Buna dhe Kir, si dhe ndikimit të liqenit të Shkodrës dhe shkarkimet nga Hecet.

Gjatë viteve të fundit situatë është përmirësuar dukshëm por përsëri kemi pasur disa raste përmytjesh, të cilat kanë prekur sipërfaqe të ndryshme të tokave bujqësore , kryesisht në njësitë administrative të Nën Shkodrës. Lidhur me kompensimin e dëmeve, theksojmë se trajtimi financiar i tyre bëhet në përputhje me parashikimet e VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, në varësi të shpalljes së gjendjes së emergjencës civile dhe plotësimit të kriterëve përkatëse.

Në kuadër të parandalimit dhe minimizimit të rrezikut nga përmytjet, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë dhe vijon të ndërmarrë masa parandaluese, ndër të cilat përfshihen: pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve kulluese, ndërhyrjet për forcimin dhe rehabilitimin e argjinaturave, mirëmbajtjen e infrastrukturës kulluese dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror për monitorimin dhe menaxhimin e situatave të përmytjeve.

Bashkia Shkodër mbetet e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve parandaluese dhe reagimin efektiv në funksion të mbrojtjes së jetës, pronës dhe aktivitetit ekonomik të qytetarëve.

KRYETAR

Benet BECI